

Krishterizmi 2000, pse?

“E gjithë Evropa mesjetare hiqte “dhimbjet e rritjes” dhe toleranca fetare s’është veçse një shpikje e ditëve tona.”

(Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*, f. 11)

Ditëve tona po dëgjojmë se në vendet muslimane, apo në tokat evropiane, po bile edhe në rrethe më të ngushta si në ato shqiptare, po mbahen simpoziume me karakter të përgjithshëm, e në veçanti me karakter fetar. Sidomos vëmendje të veçantë zgjojnë simpoziumet në lidhje me Krishterizmin. Ndërkaq simpoziumet për Krishterizmin kohën e fundit më tepër njihen me emrin „*Krishterizmi 2000*“, apo „*2000 vjetori i Krishterizmit*“ etj. Edhe pse me vetë këto shprehje synohet të tregohet, dhe kështu edhe të kuptohet nga auditoriumi shqiptar, se Krishterizmi është fe e vjetër (bile, sipas disa intelektualëve shqiptarë, edhe si fe më e vjetër e shqiptarëve), të kuptohet momenti kur ka lindur dhe se sa e vjetër është kjo si fe. Ndërkaq me rëndësi është që në mesin e këtyre rreshtave të kuptohet edhe ajo që fshihet, apo me një fjalë ajo që dëshirohet të tregohet, gjegjësisht ajo që është edhe synim kryesor i organizatorëve. Kështu që, emërtimi i këtillë i këtyre simpoziumeve shihet se përdoret vetëm si mjet për t’ia arritur qëllimit të caktuar, e qëllim i caktuar në këtë rast është të bërit të ditur të tjerëve, e në veçanti shqiptarëve, kuptohet kur është fjala për shqiptarët, se Krishterizmi është fe e vjetër, gjegjësisht „më e vjetër“ se Islami, dhe fe e vetme „origjinale“, e sidomos fe „origjinale“ e shqiptarëve. Por, përveç kësaj bëhet propaganda e asaj se kjo fe është fe e tolerancës, e paqes, e respektimit,... etj. Megjithatë, që të jem më i qartë në atë që dua të them në këtë rast, së pari dëshiroj t’i kthehem shkurtimisht historikut të shkurtër të Krishterizmit.

Kur do të pyesnim një njeri të thjeshtë se kur ka lindur Krishterizmi, ai me siguri që do të na thoshte se ka lindur në shekullin e parë. Kështu mendojnë edhe shumica e të krishterëve. Ndërkaq faktet historike, edhe pse Jezu Krishti ka lindur dhe ka jetuar në fillim të shekullit I., apo kalendari i erës sonë fillon me Krishtin (të cilin ne muslimanët e njohim si pejgamber i All-llahut i quajtur Isai a.s.)¹, tregojnë se Jezusi nuk ka propaganduar Krishterizëm dhe as që ka ekzistuar si term në kohën e tij fjala Krishterizëm. Ndërkaq ithtarët e Isait janë quajtur jesuanë (isevitë), nasuraj etj.² Kurse në anën tjetër edhe dokumentacionet që na tregojnë

¹ Muhammad Ata ur-Rahim, *Jesus, A Prophet of Islam*, London, 1980/1981, f.19-40.

² Qani Nesimi, *Ortodoksizmi te shqiptarët (Historia e religjioneve)*, Tetovë, 2005, f. 25-26.

për Jezusin/Isain dhe për Krishterizmin, ku vendin kryesor e zë Dhiata e Re, nuk datojnë që nga koha e Jezusit/Isait. Por historikisht Dhiata e Re ka filluar të shkruhet në vitet 30-35 pas kryqëzimit të Krishtit. Dhe formimi i Biblës (Dhiatës së Re) është bërë pas vdekjes së Krishtit dhe të havaritëve të tij. Pasi që një numër prej havaritëve vdesin, disa të krishterë duke grumbulluar të dhënat në lidhje me Jezusin fillojnë përgatitjen e librit që në të ardhmen do të bëhet burim numër një i besimit krishter. Kështu që në këtë rast janë bërë manipulime të mëdha. Kurse Howard Kee në lidhje me këtë manipulim thotë: „Historianët e kësaj kohe nuk janë mjaftuar vetëm me transmetimin e ngjarjeve historike, por ata janë munduar që lexuesve të asaj kohe, kur janë shkruar ato, t’ua përshtatin atë që ta kuptojnë më mirë“³. Kjo është një shprehje e cila tregon se Bibla aktuale nuk është libër origjinal hyjnor, porse në të ekzistojnë edhe shumë shtesa njerëzore. Ndoshta edhe ato shtojca në të shumtën e rasteve janë dominuese. E sidomos këtu me rëndësi është të ceket se origjinali i Biblës, që ne e posedojmë sot, nuk është në gjuhën arameje, gjuhë në të cilën ka folur Jezusi, por në gjuhën greke. Gjë e cila e vë në dyshim origjinalitetin dhe autenticitetin e vetë asaj si libër, e lëre më aspektin hyjnor të saj.⁴

Një problem tjetër me rëndësi që ka ekzistuar në atë kohë e që edhe sot është ende i paqartë është çështja e Kristologjisë, e cila në vete ngërthen atë se a thua Jezusi është Bir i Zotit (Son of God), Krisht (Christ) apo është Bir i Njerëzisë (Son of Man). Këtu me rëndësi është të përmendet edhe ajo që quhet Teotokos dhe Antropokos. E para ka kuptimin se Maria/Merjemeja ka lindur zot (Jezusin zot), pra është nëna e zotit, dhe e dyta ka kuptimin se Maria është nëna e njeriut (Jezusit njeri). Këto janë çështje të cilat edhe atëherë, por edhe sot diskutohen me të madhe, por ende nuk janë të qartësuara. Njeriu i cili më tepër i ka diskutuar këto çështje në Krishterizëm dhe i cili me mendimet e tij është bërë shtylla kryesore në këtë besim dhe i cili është edhe shpikësi i shumë çështjeve në Krishterizëm, është Shën Pali (Paulus). Emri i këtij është aq me rëndësi në Krishterizëm saqë është bërë shumë diskutabile se kush është në epiqendër të kësaj feje, Jezusi apo Pali? Kjo nxirret nga dy fjalët e Palit, ku në njërën anë ithtarëve të tij u thotë: „*Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij shumë të dashur, edhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe e dha veten e tij për ne, si ofertë e flijim Perëndisë, si një parfum erëmirë*“ (Efesianëve, 5:1-2). Kurse në anën tjetër njerëzit i thërret të bëhen si ai, gjegjësisht t’i ndjekin mendimet dhe rrugën e tij: „*Më imitoni mua, ashtu si unë jam imitues i Krishtit. Dhe unë po ju lavdëroj, vëllezër, që më kujtoni në të gjitha gjërat dhe i zbatoni porositë ashtu siç ua kam transmetuar*“ (I. Korintasve, 11:1-2), „*Ato gjëra që keni mësuar, marrë dhe dëgjuar nga unë dhe patë në mua, i bëni, dhe Perëndia i paqes do të jetë me ju*“ (Filipianët, 4:9).⁵

³ Mahmut Aydın, “Yahudi Bir Peygmaberden Gentile Tanrıya: İsan’ın Tanrısallastırılma Sureci”, *İslamiyat*, v. 3, Nr. 4, tetor-dhjetor 2000, Ankara, f. 49-52.

⁴ Mahmut Aydın, *Monologdan Diyaloga*, Ankara: Ankara Okulu, 2001, f. 53.

⁵ Më gjëresisht shih, Şinasi Gündüz, *Pavlus, Hristiyanlığın Mimarı*, Ankara: Ankara Okulu, 2001, f. 249-251.

Pas gjithë kësaj, në vitin 52 të e.s., për shkak të mosmarrëveshjeve që ndodhin mes tyre, sidomos mes ithtarëve të Palit dhe ithtarëve të Isait në krye me Jakobin, u mbajt mbledhja e parë e havaritëve në Jerusalem. Por në këtë kohë ende nuk ekzistonte Bibla, ajo doli në shesh shumë më vonë. Kurse momenti kur Krishterizmi mori hovin e madh ishte kur Mbreti i Perandorisë Romake me një ferman, të quajtur „Fermani i Milanos“, e shpalli Krishterizmin fe zyrtare. Pas kësaj pason Konkili i Nikesë me 325, i cili ka qenë iniciativë e Konstantinit, mbretit të Perandorisë Romake. Në këtë koncil është diskutuar esenca e Jezusit. Sipas Ariusit, prift në Aleksandri, i Biri (Jezusi) është *i ngjashëm* me Atin (Zotin), kurse Athanasiusi, prift në Stamboll, mbron mendimin se i Biri është *i njëjtë* me Atin. Dhe në këtë koncil legjitimitet fiton mendimi i Athanasiusit. Kështu që Ariusi shpallet heretik. Dhe kështu mbas këtyre koncilëve mbahen edhe shumë koncilë të tjerë, ku më kryesorë janë shtatë të parët që janë mbajtur deri në vitin 787. Këto janë edhe koncilë të cilët Kisha Ortodokse i pranon si të vetëm dhe legjitim. Ndërkaq Kisha Katolike vazhdon me koncilët e saj dhe si koncilë të fundit të Kishës Katolike njihen dy koncilët e Vatikanit, ku i pari është mbajtur më 1869-1870 dhe i dyti me 1962-1965.⁶

Përveç kësaj është me rëndësi të ceket se kisha, përveç këtyre mosmarrëveshjeve që i ka përjetuar ajo edhe vetë, për të ruajtur unin e saj, ka krijuar probleme, ka vrarë apo ka masakruar njerëz. Këtu si shembull mund të përmendim Donatusin, gjegjësisht Donatizmin, i cili është themeluar në fillim të shek. 4. nga ana e Donatusit dhe mendimin që mbronte ishte se Isai ka qenë njeri dhe peygamber. Por kjo lëvizje nga ana e Kishës së Palit u shua duke u realizuar një gjenocid i paparë deri më atëherë.⁷ I njëjtë është rasti edhe me Jan Hus-in (1372-1415), i cili ishte njëri prej reformistëve krishterë. Sipas tij duhej të ndryshonte etika, jeta dhe forma e të menduarit e priftërinjve. Dhe për këtë u dënua nga kisha dhe u dogj si heretik.⁸ Si raste të ngjashme mund të përmenden edhe qëndrimet e kishës ndaj mendimeve të Nikolla Kopernikut, Gjordano Brunos dhe të Galile Galileut.

Gjithashtu në historinë e kishës është një rast shumë me rëndësi për t’u përmendur, i cili është edhe një plagë e pashërueshme, sidomos deri tash, e kishës në përgjithësi, e ajo është ndodhia e quajtur Skizma e Madhe (1054). Kjo quhet skizma/ndarja e madhe sepse edhe përpara kësaj ka ndodhur një ndarje dhe ajo ka qenë ndarja mes *diofizitëve* (rrymë kristologjike që pretendon se në Jezu Krishtin ekzistojnë dy natyra, ajo njerëzore dhe ajo hyjnore, të pandara dhe të papërziera) dhe *monofizitëve* (rrymë kristologjike që pretendon se në Jezu Krishtin ekziston vetëm natyra hyjnore, kurse ajo njerëzoria është zhdukur në atë hyjnoren). Kurse kjo ndarje e madhe (*the great schism*) është bërë për shumë arsye edhe atë më shumë për çështje fetare. Njëra prej arsyeve fetare është arsyeja e quajtur *filioque* (edhe i biri), që do të thotë se Shpirti i Shenjtë ka dalë edhe prej Atit edhe prej Të Birit (këtu ka edhe shumë arsye të tjera që unë nuk e shoh të arsyeshme që të përmenden në këtë moment). Ky është besimi i Kishës Katolike, kurse Kisha

⁶ Shih, Francis Dvornik, *The Ecumenical Councils*, New York: Hawthorn Books, 1961.

⁷ Şinasi Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, Ankara: Vadi, 1998, f. 100.

⁸ Vep. e cit., f. 175.

Ortodokse e mohon një gjë të tillë dhe thotë se Shpirti i Shenjtë ka dalë vetëm prej Atit. Këtu në këtë ndodhi, të dyja kishat, edhe ajo lindorja edhe ajo perëndimorja, kanë shpallur njëra-tjetrën heretike, gjegjësisht pa fe apo jo të krishterë. Kjo është një armiqësi që ekziston edhe sot e kësaj dite.⁹ Ndërkaq pas kësaj pason edhe ndarja e tretë e njohur në historinë e Krishterimit si lindja e Protestantizmit, themelues i të cilit është prifti Marthin Luther. Dhe e gjithë kjo ka lindur për shkak të asaj se dikush ka dashur që fenë ta mbajë vetëm për të mbrojtur karrierën e tij personale apo për të bërë biznes personal.¹⁰

Me rëndësi është edhe përmendja e luftërave të kryqëzatave të organizuara nga Kisha Katolike. Lufta e Kryqëzatave ka filluar kah fundi i shek. XI edhe atë me luftën e parë të organizuar nga Papa Urbani II, më 1095. Ky ka qenë momenti kur armiqësia mes muslimanëve dhe të krishterëve ka arritur kulmin e saj, me ç'rast edhe në ditët e sotme shihen gjurmët e asaj armiqësie të krijuar nga ana e Kishës Katolike. Numri i këtyre luftërave, të bëra ndaj muslimanëve me qëllim të marrjes së Jerusalemit, ka arritur deri në tetë. Qëllimi final i tyre ka qenë fetar. Ushtarët krishterë kanë besuar plotësisht se luftën që e bëjnë ndaj muslimanëve dhe, gjithashtu, edhe vrasjen e muslimanëve e kanë besuar si obligim fetar. Për këtë ata kanë besuar se sa më shumë muslimanë që të vrasin arrijnë sevape dhe shpëtim, që në fund rezulton me xhennet. Kështu që, transmetohet se vetëm gjatë dy ditëve nga dora e kryqtarëve janë vrarë 40.000 muslimanë.¹¹

E tash t'i kthehemi temës për të cilën edhe e paraqitëm këtë historik të shkurtër të Krishterizmit. Për momentin mund të bëjmë pyetje se pse këto simpoziume për Krishterizmin dhe se pse ato të quhen "*Krishterizmi 2000*", apo "*2000 Vjetori i Krishterizmit*"? dhe kështu me radhë.

Pra nëse dëshirohet që Krishterizmi të tregohet si fe e tolerancës, e mirëkuptimit, e paqes etj., së pari kisha, pa marrë parasysh se a është Kisha Katolike apo ajo Ortodokse, duhet që të përmirësojë gabimet e saj historike duke kërkuar falje dhe duke mos i kryer më të njëjtat veprime, qofshin ato veprime misionarike të hapura apo të fshehura, gjegjësisht duke folur për dialogun a në fakt të kihet për qëllim misionarizmi. Pra, pa mos u pajtuar dy kishat njëra me tjetrën çdo gjë që flitet apo veprohet është false. Por, përveç kësaj ajo duhet edhe të caktojë dhe të bëjë të qartë qëndrimin e saj ndaj feve të tjera, e sidomos ndaj muslimanëve. Edhe pse në Koncilin e Dytë të Vatikanit Kisha Katolike, për herë të parë në historinë e kishës, merr disa qëndrime ndaj muslimanëve, që është për t'u përgëzuar, por mbetet edhe shumë për t'u bërë në lidhje me këtë çështje, të cilat janë shumë me mangësi. Bile, aty krahas asaj që flitet për disa parime islame mundohet të mbrohet katolikocentrizmi dhe duke dashur që të flitet për dialogun mundohet të realizohet aspekti misionarik i Kishës Katolike, gjë e cila në vend që ta zgjidhë ajo ende më

⁹ Timothy Ware, *The Orthodox Church*, New York: Penguin Books, 1963, f. 51-81.

¹⁰ Për këtë më gjërësisht shih, Hakan Olgun, *Luther ve Reform, Katolisizm'i Protesto*, Ankara: Fecr, 2001.

¹¹ Mahmut, vep. e cit. f. 44-47.

tepër e ngatërron çështjen.¹² Ndërkaq Kisha Ortodokse, përveç bisedave të shumta që janë thënë deri tani, të cilat nuk kanë ndonjë peshë juridike dhe fetare për përmirësimin e kësaj *status quo*-je, ajo nuk ka bërë asnjë lëvizje në drejtim të zgjidhjes së kësaj çështjeje.

Ndërsa sa i takon asaj se shqiptarët fe të tyre origjinale apo më të vjetër kanë Krishterizmin nuk është aspak e vërtetë, sepse Krishterizmi gjenezën e ka në shekullin e parë të erës sonë, ndërsa si fe e formuar daton prej shekullit të katërt të erës sonë. Kurse shqiptarët datojnë shumë më herët se Krishterizmi. E kur është fjala se Katolicizmi është fe e parë e shqiptarëve, kjo është ende më qesharake se ajo që u tha para kësaj, sepse më shumë është me qëllim propagandistik, për shkak se Katolicizmi së pari herë del në shesh në vitin 1054 të e.s. Por në këtë rast, ata të cilët zgjedhin Katolicizmin për fe të parë dhe origjinale të shqiptarëve, do t'i kisha pyetur se çfarë ka qenë feja e shqiptarëve para Katolicizmit dhe atyre të cilët për fe të parë dhe origjinale për shqiptarët e marrin Krishterizmin, do t'i kisha pyetur se a shqiptarët apo Krishterizmi është më i vjetër, kur dihet se Krishterizmi ka lindur mijëra vite pas shqiptarëve?¹³ Por disa intelektualë shqiptarë të cilët për shqiptarët parapëlqejnë Katolicizmin do t'i kisha pyetur se, pasi që dihet se para Krishterizmit fe dominuese në Evropë ka qenë Maniheizmi¹⁴, pse nuk e marrim Maniheizmin si fe origjinale, apo nëse në të ardhmen ndodh që Katolicizmi/Krishterizmi, pasi feja është një dukuri subjektive e njeriut dhe nuk mund t'i imponohet atij, të ndërrohet me një besim tjetër, atëherë çfarë do të ndodhë me fenë “e parë” dhe “origjinale” të shqiptarëve?

Sa për fund do të kisha thënë se, nëse Krishterizmi dëshiron ta zërë vendin e vet në mesin e feve të tjera, atëherë ajo duhet që të marrë mësim nga gabimet e bëra më herët, që ato të mos përsëriten edhe një herë, dhe ta lërë misionarizmin dhe ta kapë dialogun me seriozitet. Përndryshe, rruga e kundërt është në dëm edhe të vetë asaj si fe. Me respekt ndaj të gjithë atyre që merren ose tentojnë të merren me dialog serioz.

¹² Vep. e cit., f. 111-112

¹³ Edwin E. Jacque, *Shqiptarët I.*, Stamboll: Yeni Yaşam, 1996, f. 3-39.

¹⁴ Gündüz, vep. e cit., f. 245.